qKn

TAKSA E PULLES
U PAGUA
ERMAL HAMZAJ

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 2385 **Rep.**
**Nr.** 1562 **Kol.**

**KONTRATË DHURIMI**
**KUOTASH**

Në Tiranë, sot në datën 17 /11/2015 (dymijë e pesembëdhjetë), përpara meje noterit publik Ermal Xh. HAMZAJ, i regjistruar në Dhomën e Noterëve Tiranë, në zyrën time noteriale me adresë Rr "Ismail Qemali", Nd.4, H.1, Njësia Bashkiake Nr. 5, u paraqitën personalisht palët me gjeneralitetet si më poshtë:

**Hazbi AZIZAJ**, atesia Mehmet, i datelindjes 17.10.1948, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit nr. personal E81017079N, ***me poshte referuar si "Dhuruesi";***

dhe

**Kastriot HAMITI**, atesia Zenel, i datelindjes 17.07.1954, lindur ne Kuçove dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor, me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. personal F40717074M, ***me poshte referuar si "Pranuesi i dhurimit";***

**HYRJE**

*Duke konsideruar faktin se z. Hazbi Azizaj eshte ortak i shoqerise* ***"BALKANENGINEERING" SHPK****, shoqeri tregtare e te drejtes Shqiptare, e regjistruar ne regjistrin tregtar ne daten 10.06.2005, me nipt nr. K52212016C dhe zoteron 50 kuota/pjese, qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te shoqerise,*

*Duke konsideruar faktin qe dhuruesi, z. Hazbi Azizaj, deshiron ti dhuroj ortakut ekzistues z. Kastriot HAMITI kuotat qe ai zoteron ne shoqeri, qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te shoqerise pa asnje kundershperblim.*

*Duke konsideruar faktin qe z. Kastriot HAMITI deklaron se pranon dhurimin e kuotave qe i behet nga z. Hazbi Azizaj, konkretisht 50 kuota qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te shoqerise, pa asnje kundershperblim.*

Palët me vullnet të lirë dhe të plotë më kërkuan mua noterit redaktimin e këtij kontratë dhurimi kuotash, me përmbajtje si më poshtë vijon :

**Neni 1**
**Qëllimi i kontratës**

**1.**Kjo kontratë shërben për përcktimin e kritereve, procedurave dhe mënyrës së tranferimit të pronësisë te kuotes, objekt te kesaj kontrate nga Dhuruesi, tek Pranuesi i dhurimit.

2.Në përcaktim te kushteve, palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

## Neni 2
## Objekti i kontrates

1.Objekti i kesaj kontrate eshte transferimi teresisht i pronesise te 50 kuotave qe dhuruesi zoteron ne shoqeri, qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise, pa asnje kundershperblim ne favor te ortakut ekzistues z. Kastriot HAMITI.
2. Dhurimi i 50 kuotave, qe perfaqesojne 50 % te kapitalit te shoqerise, nga dhuruesi, z. Hazbi AZIZAJ, tek pranuesi i dhurimit, z. Kastriot HAMITI do te behet pa kundershperblim apo detyrim tjeter ligjor.

## Neni 3
## Pergjegjesite dhe garanci te dhuruesit

Dhuruesi, nepermjet kesaj kontrate, garanton pranuesin e dhurimit si me poshte:

a) se kuotat objekt dhurimi jane plotesisht te lira nga çdo barre, apo kufizim i mundshem mbi to;
b) se miratimi per transferimin e kuotave, objekt te kesaj kontrate ne drejtim te pranuesit te dhurimit eshte marre ne pajtim te plote me ligjin tregtar ne fuqi dhe statutin e shoqerise;
c) dhuruesi deklaron nen pergjegjesine e tij personale se me nenshkrimin e kesaj kontrate, ai heq dore nga te gjitha te drejtat qe i kane takuar ne cilesine e ortakut ne shoqeri, apo cdo te drejte tjeter pa kufizim ku perfshihen te drejta pune, dividenti etj

## Neni 4
## Efektet e kontrates

1. Kjo kontrate ka fuqine e ligjit per palet nga momenti i nenshkrimit te saj.
2. Kontrata ka efekt per palet e treta ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

## Neni 5
## Informacioni konfidencial

Palet detyrohen te mbajne te fshehte te gjithe dokumentacionin, te dhenat dhe cdo informacion tjeter te perfituar gjate marredhenies se tyre ne perputhje me kete kontrate.

## Neni 6
## Transferimi i te drejtave

1. Menjehere mbas nenshkrimit te paleve, kontrata do te regjistrohet ne regjistrin tregtar per te bere te mundur transferimin e kuotave ne emer te ortakut Kastriot HAMITI.
2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, dhuruesi zhvishet teresisht nga pronesia mbi 50 kuota qe perfaqeson 50% te kapitalit qe ai zoteron ne shoqeri dhe zoteruesi i tyre behet pranuesi i dhurimit, z. Kastriot HAMITI.

## Neni 7
## Interpretimi i kontates

1. Nese do te jete e nevojshme te behet interpretimi i kesaj kontrate, do te synohet te percaktohet se kush ka qene qellimi real dhe i perbashket i te dyja paleve, pa u mbeshtetur ne kuptimin literal te fjaleve, dhe gjithashtu duke vleresuar sjelljen e tyre ne teresi, perpara dhe pas perfundimit te kesaj kontrate.
2. Kushtet e kesaj kontrate do te interpretohen njera pas tjetres, duke dhene seicila kuptimin qe rrjedh nga teresia e kontrates ne fjale. Kontrata do te interpretohet ne konfidence nga palet.

**Neni 8**
**Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente**

1 Kontrata eshte hartuar dhe interpretuar ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe ligjet tregtare ne fuqi.
2 Dhuruesi dhe Pranuesi i dhurimit angazhohen te bejne cdo perpjekje te zgjidhin mosmarreveshjet apo konfliktet e krijuara midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negocimeve te drejteperdrejta.
3 Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve apo konflikteve midis tyre, ato do ti drejtohen juridiksionit gjyqesor per zgjidhjen e tyre.

**Neni 9**
**Dispozita perfundimtare**

1.Kjo kontrate eshte hartuar ne 4 (kater) kopje, ne gjuhen Shqipe, nga nje per secilen pale, e cila ju lexua me ze te larte e te qarte paleve te mesiperme nga une noteri.

2.Pas leximit, ato deklaruan perpara meje noterit se e kuptuan dhe pasi e gjeten kete akt ne perputhje me vullnetin e tyre, e nenshkruan kete akt perpara meje noterit pa asnje rezerve.

3.Mbas nenshkrimit te kesaj kontrate nga palet e mesiperme, une noteri e vertetova ate ne perputhje me ligjin "Mbi noterine" (I ndryshuar).

**PALËT KONTRAKTORE**

**DHURUESI** | **PRANUESI I DHURIMIT**

NOTERI

NOTER
ERMAL XH. HAMZAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISE DHE SIPERMARRJES,
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT

OKR
Qendra Kombëtare e Regjistrimit
National Registration Center

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

Kopje nga web

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K52212016C | |
| 2. Data e Regjistrimit | 10/06/2005 | |
| 3. Emri i Subjektit | BALKANENGINEERING SH.P.K. | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 06/06/2005 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 06/06/2005 Deri: | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE GJIN BUE SHPATA | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Supervizim, kolaudim dhe projektim ne fushen e ndertimit, mekanike, elektrike dhe topogjeodezike ne zerat qe vijojne; punime dheu, sistemime taracime terrenesh, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj, deri dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj mbi dy kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to. Projektime konstruksione ndertimi. Import eksport dhe tregti me shumice e pakice te artikujve te ndryshem | |
| 10. Administratori/ët | Kastriot Hamiti | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 18/08/2010 | Deri: 18/08/2015 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | Hazbi Azizaj | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 50,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| - *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Ortakët | Kastriot Hamiti | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 50.000,00 | Natyre: |

| | |
|---|---|
| 13.2 Numri i pjesëve | 50,00 |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: BALKANENGINEERING SH.P.K. |
| 16. Statusi: | Aktiv |

Datë: 10/11/2015

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

NOTER
TIRANE




